



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**RREGULLORE (QRK) NR.29/2024 PËR PËRFUNDIMIN E  
MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore (QRK) Nr. 29/2024 për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, është miratuar në mbledhjen e 221-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 09/221, të datës 23.09.2024

**Qeveria e Republikës së Kosovës**, mbështetur në paragrafin 4 të nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafin 5 të nenit 74 dhe paragrafin 4 të nenit 76 të Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 8, paragrafin 4, nënparagrafin 4.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 78, paragrafin 6, nënparagrafin 6.2 të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

## **RREGULLORE NR. 29/2024 (QRK) PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL**

### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton rregullat, procedurat dhe shkaqet për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha kategoritë e nëpunësve civil në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e tjera shtetërore.
2. Për nëpunësit e Presidencës së Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, kjo Rregullore zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë.

### **Neni 3 Përkufizimet**

Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

### **Neni 4 Përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil**

1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon në rastet si në vijim:
  - 1.1. për shkaqe të përcaktuara me ligj;
  - 1.2. me lirim nga shërbimi civil;
  - 1.3. me largimin nga shërbimi civil, si masë disiplinore.

### **Neni 5 Përfundimi në rastet e përcaktuara me ligj**

1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon në rastet si në vijim:
  - 1.1. nëpunësi vdes, apo merr formë të prerë vendimi për deklarin e vdekjes së tij;

- 1.2. nëpunësi humb shtetësinë, kur ajo kërkohet;
  - 1.3. kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
  - 1.4. arrihet mosha për pensionim sipas Ligjit përkatës për Punë;
  - 1.5. konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit;
  - 1.6. nëpunësi dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.
2. Nëpunësi civil informohet për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të plotësimit të moshës së pensionimit, gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit nga njësia përgjegjëse.
  3. Përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak të ligjit, konstatohet brenda shtatë (7) ditëve nga ndodhja apo njohja e shkakut të përfundimit, me vendim nga NjMBNj e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën.
  4. Për nëpunësin e kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore, konstatimi për përfundimin e marrëdhënies së punës bëhet me vendim të DMZP-së.

## **Neni 6**

### **Lirimi nga shërbimi civil**

1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me lirim nga shërbimi civil, në këto raste:
  - 1.1. për shkak të refuzimit të paarsyetuar të nëpunësit për të pranuar transferimin;
  - 1.2. kur nëpunësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas legjislacionit në fuqi;
  - 1.3. pas dy (2) vlerësimeve “e papranueshme” të rezultateve në punë, dy (2) herë radhazi. Si herë e dytë radhazi konsiderohet edhe vlerësimi i veçantë;
  - 1.4. kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionim të parakohshëm;
  - 1.5. kur nëpunësi i kategorisë së ulët, mesme apo të lartë drejtuese anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike;
  - 1.6. kur nëpunësi civil që ka pezulluar vendin e punës me kërkesën e tij, themelon marrëdhënie tjetër pune;
  - 1.7. me dorëheqje;
  - 1.8. nëpunësi refuzon sistemimin në një pozitë të lirë pas procesit të ristrukturimit, refuzon sistemimin nga lista e pritjes, apo refuzon sistemimin në pozitën e kategorisë

profesionale pas përfundimit të mandatit;

1.9. nëpunësi i kategorisë së lartë drejtuese, refuzon ndjekjen e programit të veçantë të trajnimit të detyrueshëm për nëpunësin e kategorisë së lartë drejtuese;

1.10. nëpunësi në listën e pritjes refuzon t'i nënshtrohet trajnimeve;

1.11. nëpunësi në listën e pritjes, nuk ricaktohet në një pozitë të lirë të shërbimit civil, brenda afatit prej nëntë (9) muajsh;

1.12. në çdo rast tjetër, të parashikuar me ligj.

2. Lirimi nga shërbimi civil, në rastin e parashikuar sipas paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3 të këtij neni, konstatohet brenda dhjetë (10) ditëve nga dhënia e vlerësimit të dytë “e papranueshme”, ndërsa në rastet e tjera konstatohet brenda dhjetë (10) ditëve nga njohja e shkakut për lirim.

3. Lirimi nga shërbimi civil bëhet me vendim të:

3.1. NjMBNj-së, ku nëpunësi ushtron detyrën;

3.2. Qeverisë, me propozim të ministrit përgjegjës për Administratën Publike për nëpunësin e kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore.

## **Neni 7 Dorëheqja**

1. Nëpunësi civil mund të ofrojë dorëheqje nga shërbimi civil. Dorëheqja përbën shkas ligjor për lirim të nëpunësit nga shërbimi civil.

2. Përveç dorëheqjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëpunësi civil i emëruar në kategorinë e ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese që ka qenë në shërbim civil para emërimit, mund të ofrojë dorëheqje vetëm nga pozita drejtuese që mban.

3. Nëpunësi civil sipas paragrafit 2 të këtij neni, sistemohet në një pozitë të lirë të kategorisë profesionale me kusht që plotëson kriteret për emërim në pozitën në fjalë.

4. I emëruari në kategorinë e ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese që nuk ka qenë në shërbimin civil para se të emërohet në pozitën për të cilën ofron dorëheqjen, lirohet nga shërbimi civil.

5. Deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale, nëpunësi civil vendoset në listën e pritjes.

6. Nëpunësi civil ofron dorëheqjen me shkrim tek NjMBNj e institucionit ku ushtron detyrën, ose tek DMZP në rastin e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese dhe mban të njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë.

7. Nëpunësi civil intervistohet nga NjMBNj e institucionit ose dorëzon me shkrim arsyen e largimit.

8. Dorëheqja krijon pasoja juridike tridhjetë (30) ditë nga data e paraqitjes, përveç në raste të arsyetuara, me kërkesë të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë përgjegjëse, dorëheqja krijon pasoja juridike përpara afatit tridhjetë (30) ditor nga dita e njoftimit për dorëheqje.

9. Lirimi nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes së nëpunësit civil, konstatohet nga NjMBNj e institucionit ku nëpunësi ushtron detyrën, ose nga DMZP në rastin e nëpunësve të kategorisë së lartë drejtuese.

### **Neni 8 Pensionimi i parakohshëm**

1. Pensionimi i parakohshëm i nëpunësit civil përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimi civil.

2. Nëpunësi civil mund të kërkojë pensionim të parakohshëm, jo më shumë se dy (2) vite para afatit të përcaktuar për pensionimin e tij. Kërkesa për pensionim të parakohshëm, duhet të miratohet nga udhëheqësi më i lartë i institucionit.

3. Institucioni publik mund të përshpejtojë pensionimin në rast të reduktimit të personelit, pas një riorganizimi, bashkimi me një institucion tjetër, mbylljes së institucionit ose shuarjes së pozitave, për ata nëpunës civil që janë dy (2) vite para datës së pensionimit.

4. Pagesa për pensionim të parakohshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni është shtatëdhjetë për qind (70%) e pagës bazë të fundit të pranuar deri në arritjen e moshës së pensionimit.

### **Neni 9 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (QRK) Nr.13/2020 për Lirimin dhe Pensionimin e Parakohshëm nga Shërbimi Civil.

### **Neni 10 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

**Kryeministër i Republikës së Kosovës**

**04 tetor 2024**